



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Didaktika e gjuhëve të huaja (gjuhe frenge)

Ngarkesa: 3 ETC, 30 leksione/ 10 seminare

Viti / Semestri : Viti i tretë, Semetri i parë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Gjuhë, letërsi dhe qytetërim francez”

Kodi i etikës: Kodi i etikës së UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT :

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs ka si qëllim të zbulojë didaktikën e gjuhëve të huaja në kontekste të ndryshme dhe kryesisht frankofone- nëpërmjet një reflektimi të udhëhequr nga problematikat dhe përmbajtjet e saj. Ai synon që studentët: Të përftojnë njohuri bazë rreth kontekstit të mësimdhënies/mësimnxënies të gjuhës së huaj. Të kuptojnë dhe të dallojnë metodologjitë/qasjet e mësimdhënies/mësimnxënies. Të analizojnë dhe të kenë mendim kritik mbi teori apo strategji të ndryshme të mësimdhënies/mësimnxënies. Të zotërojnë mjetet didaktike dhe pedagogjike. Të lidhin teorinë me praktikën. Të zhvillojnë mendimin krijues. Të mësojnë dhe të bashkëpunojnë në grup.

Objektivat specifike lëndore:

Kjo lëndë synon që studentët të dinë:

1. Të krahasojnë metodologji të ndryshme të mësimdhënies/ mësimnxënies së gjuhëve të huaja.
2. Të dallojnë dhe të argumentojnë strategji të ndryshme të mësimdhënies dhe nxënies së gjuhëve të huaja.
3. Të demonstrojnë nivel të lartë në njohjen e njohurive bazë të llojeve të ndryshme të metodave të mësimdhënies së gjuhës së huaj dhe kompetencave komunikuese në gjuhë të huaj.

Rezultatet e pritshme :

Gjatë zhvillimit të lëndës studenti do të përftojë:

1. Aftësinë për të arsyetuar, argumentuar dhe sistemuar njohuritë nëpërmjet studimit të materialeve, diskutimeve dhe paraqitjes së punimeve përgjatë kursit.
2. Aftësinë për të ushtruar mendim analitik, kritik, logjik dhe krijues në interpretimin e materialeve të ndryshme.
3. Aftësinë për të bërë punë në grup si edhe kërkime vetjake për detyrat që do t'i ngarkohen.